# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5531
E premte, 20 korrik 2018
çmimi 0.40 €


## LDK-ja kërkon zgjedhje të parakohshme FAQE 7



Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka përsëritur të enjten kërkesën e kësaj partie, se vendi nuk mund të qeveriset nga koalicioni i pakicës i cili nuk ka legjitimitet


Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", BLERTA DELIU-KODRA FAQE 4-5

# Procesi i liberalizimit të vizave do të përfundojë këtë vit



### - Kosova do të ketë dinamikë të re të lobimit për liberalizimin e vizave te vendet e BE-së

Kryetarja e Komisionit për Integrime Evropiane në Kuvendin e Kosovës, Blerta Deliu-Kodra, ka vlerësuar se rekomandimi për heqjen e vizave për Kosovën paraqet një çast të rëndësishëm për realizimin e një të drejte të shumëpritur. Duke u bazuar në përmbushjen e kritereve dhe takimet me përfaqësuesit e BE-së, ajo ka shprehur optimizëm se procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës do të përfundojë këtë vit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Deliu-Kodra ka theksuar se aprovimi i vendimit për vizat do të jetë më i lehtë në Parlamentin Evropian, ndërsa më kompleks në Këshillin e Ministrave. Ajo ka paralajmëruar se institucionet e Kosovës do ta kenë një dinamikë të re të lobimit për liberalizimin e vizave për t'i bindur vendet anëtare të BE-së se kosovarët nuk do ta keqpërdorin këtë proces

## Thaçi shpreson se marrëveshja me Serbinë do të arrihet brenda gjashtë muajve FAQE 3



Pavarësisht prej vështirësive dhe dallimeve të mëdha, dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë në mënyrë që brenda gjashtë muajve të ardhshëm të arrihet marrëveshja finale për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Kështu ka deklaruar të enjten në një konferencë me gazetarë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Presidenti sërish u ka bërë thirrje partive politike t'i bashkohen procesit të dialogut dhe të kontribuojnë për arritjen e marrëveshjeve finale me Serbinë

## Ismaili: 70 për qind të barnave i kemi me kontrata



Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se furnizimi me barna esenciale është përmirësuar për faktin se tanimë 70 për qind e barnave janë me kontrata. Këto komente Ismaili i ka bërë të enjten gjatë pranimit të pajisjeve mjekësore për Klinikën e Kardiokirurgjinë nga Ambasada e Italisë, pajisje këto që kapin shifrën 370 mijë euro FAQE 7


### AKTUALE

REKTORI DEMA SHPREHET I KËNAQUR ME PËRGATITJET RRETH ORGANIZIMIT TË PROVIMIT F. 7

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN PËR GJASHTË MUAJ KA ZGJIDHUR MBI 8 000 LËNDË F. 11

AMBASADORI CUFAJ DORËZOI KREDENCIALET TE PRESIDENTI I GJERMANISË F. 6

### EKONOMI

AKB-JA: MBI 60 MILIONË EURO BIZNESET DHE QYTETARËT SHPENZUAN PËR VIZA F. 9

HARADINAJ OFRON PËRKRAHJE PËR OEK-un F. 9

### KULTURË

PARKU ARKEOLOGJIK ULPIANA DO TA KETË MBËSHTETJEN E MKRS-së F. 13

### SPORT

2 KORRIKU, NË DUAR TË SIGURTA F. 18

UJKANI LË ITALINË PËR TURQINË F. 18



RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Kitaroviq: BE-ja njohu progresin e Shqipërisë

"Kroacia e mbështet fuqishëm rrugën e Shqipërisë drejt integrimit të Bashkimit Evropian dhe mirëpret të gjithë progresin e dukshëm që është bërë nga Shqipëria, për përmbushjen e kritereve të kërkuara për anëtarësimin në BE", tha presidentja kroate Kolinda Grabar-Kitaroviq para deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë

Tiranë, 19 korrik - Presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitaroviq, mbajti fjalën e saj të nderit përpara deputetëve gjatë seancës të së enjtes në Parlamentin shqiptar, duke nënvizuar se Kroacia do ta mbështesë fuqishëm Shqipërinë drejt anëtarësimit në BE. "Kroacia e mbështet fuqishëm rrugën e Shqipërisë drejt integrimit të Bashkimit Evropian dhe mirëpret të gjithë progresin e dukshëm që është bërë nga Shqipëria, për përmbushjen e kritereve të kërkuara për anëtarësimin në BE. Sot, si një komb i ri, energjik, i zellshëm dhe i angazhuar ndaj vlerave demokratike perëndimore, Shqipëria ka perspektiva të shkëlqyera dhe është mjaft e rëndësishme të theksohen shembujtë pozitivë dhe Bashkimi Evropian duhet ta vlerësojë për këtë gjë. Do të doja t'iu përgëzoja edhe për vendimin e Këshillit, i cili ka njohur progresin e bërë nga Shqipëria. Kjo shtron rrugën për çeljen e negociatave në qershor të 2019-s", tha presidentja kroate Grabar-Kitaroviq.



Për këtë arsye, theksoi ajo, në vitin që vjen është mjaft e rëndësishme të sigurohet një bashkim kombëtar për çështje strategjike, me qëllim që të ruhet motivimi për reformat. "Në këtë kontekst, duhen pranuar dhe njohur reformat që Shqipëria ka bërë deri më sot, veçanërisht ato në fushën e gjyqësorit. Është mjaft e rëndësishme të theksohet rëndësia e procesit të vetingut, i cili do ta rrisë besimin në institucionet gjyqësore që përbëjnë edhe bazën e pushtetit ligjor", theksoi Kitaroviq.

Presidentja kroate tha se do ta ndihmojë Shqipërinë për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve shqiptare, duke ndarë edhe përvojën si shteti më i ri i anëtarësuar në BE, duke shtuar se Shqipëria ka qenë mike e Kroacisë kur miqtë ishin të paktë. "Shumë shqiptarë sakrifikuan jetën e tyre për Kroacinë. Ne nuk harrojmë", tha Kitaroviq. "Hapja e Ambasadës së Kroacisë në Tiranë në vitin 1994 ishte një ngjarje e madhe për marrëdhëniet mes dy vendeve. Tani, Kroacia dhe Shqipëria marrin pjesë bashkë në operacionet në Afganistan. Kroacia e mbështet fuqishëm perspektivën evropiane të Shqipërisë, rrugën drejt integrimit në BE dhe mirëpret progresin e bërë nga Shqipëria", tha presidentja e Kroacisë.

Presidentja e Republikës së Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitaroviq, nisi të mërkurën vizitën zyrtare në Tiranë, ku është pritur me një ceremoni shtetërore në presidencë nga Ilir Meta.

Gjatë vizitës së saj presidentja e Kroacisë zhvilloi takime të veçanta me kryeministrin Edi Rama dhe kryetarin e Kuvendit, Gramoz Ruçi, si dhe të enjten mbajti një fjalë përshëndetëse para deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë. Gjithashtu, presidentja e Kroacisë gjatë qëndrimit në Tiranë do të takohet edhe me kryetarin e Partisë Demokratike, Lulzim Basha.

# Pacolli pret leje për të hyrë në Serbi

Prishtinë, 19 korrik - Zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli, është në pritje të përgjigjes nga autoritetet e Serbisë për të hyrë në këtë shtet, me qëllim të pjesëmarrjes në një aktivitet. Pacolli është ftuar në Beograd për të marrë pjesë në një konferencë të Këshillit Kombëtar Boshnjak të Serbisë, më 21 dhe 22 korrik. "Ne jemi duke pritur një përgjigje nga pala serbe në bazë të marrëveshjes së Brukselit për lëvizje të lirë", ka thënë Jetlir Zyberaj, këshilltar i ministrit të Jashtëm. Serbia dhe Kosova, në kuadër të dialogut politik për normalizimin e marrëdhënieve, kanë nënshkruar marrëveshje për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe vizitat e zyrtarëve në vitin 2014.



LAJME SHKURT

## Bushati: Shqipëria, rol progresiv për politikën e jashtme në rajon



Tiranë, 19 korrik - Ditmir Bushati thotë se Qeveria mbetet e angazhuar për t'i përfshirë në nisma e projekte konkrete bashkëpunimi rajonal të gjithë grupet e interesit në kuadër të nisjes së procesit përgatitor mbi bisedimet për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Gjatë fjalës së tij në Kuvend, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme u shpreh se "një prani më e shtuar e selive rajonale në Tiranë jo vetëm flet qartë për një qëndrim më të balancuar të nismave në rajonin tonë, po dhe dëshmi e pjekurisë së Shqipërisë".

Ministri garantoi se Qeveria do t'i mbështesë këto nisma fuqimisht jo vetëm në kuptimin politik, financiar e logjistik, po dhe dëshmi e pjekurisë së Shqipërisë dhe rolit gjithnjë e më në rritje që Shqipëria ka për sa i përket politikës së jashtme në rajon.

Kreu i diplomacisë shqiptare bëri me dije se shumë shpejt në Kuvend vjen për ratifikim edhe marrëveshja për selinë e Fondit të Bashkëpunimit Rinor Rajonal, një tjetër nismë rajonale me qendër në Tiranë. Kjo strukturë, me fokus kryesisht te çështjet e bashkëpunimit rinor, është iniciativë e kryeministrit Rama dhe Vuçiq, mbështetur nga praktika më e mirë e ndërtimit të marrëdhënieve në këtë gjeneratë, te praktika franko-gjermane.

Bushati falënderoi edhe vendet e Vishegradit, pasi nisi atje në mënyrë simbolike me fond simbolik, dhe me kalimin e viteve, për shkak të vullnetit politik të demonstruar nga qeveritë, u fuqizua.

## Busti i Pjetër Arbnorit vendoset para Parlamentit



Tiranë, 19 korrik - Të enjten u vendos para sallës së seancave parlamentare busti i Pjetër Arbnorit, ku morën pjesë presidenti i Republikës, Ilir Meta, kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, kryetari i PD-së, Lulzim Basha, ish-kryeministri Berisha, familja e Pjetër Arbnorit, deputetë dhe ish-deputetë.

Pjetër Arbnori është Mandela shqiptar, i cili vuajti në burgjet e komunizmit dhe më pas ishte frymëzimi i krejt lëvizjes antikomuniste të Dhjetorit bashkë me heroin e Lëvizjes së Dhjetorit, Azem Hajdari. Ai ishte kryetar i Kuvendit të Shqipërisë më 1992-1997.

Arbnori mbetet simbol i vuajtjes, tolerancës, qetësisë, mençurisë, urtësisë dhe kurajës. Fjalën e hapjes për vendosjen e bustit të Arbnorit e mbajti Gramoz Ruçi, kurse shkrimtari dhe politikani i mirënjohur Besnik Mustafaj mbajti një fjalim.

Në fund foli dhe vajza e Pjetër Arbnorit.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka mbajtur konferencë për medie në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi dhe për procesin e liberalizimit të vizave

# Thaçi shpreson se marrëveshja me Serbinë do të arrihet brenda gjashtë muajve

Pavarësisht prej vështirësive dhe dallimeve të mëdha, dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë në mënyrë që brenda gjashtë muajve të ardhshëm të arrihet marrëveshja finale për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Kështu ka deklaruar të enjten, në një konferencë me gazetarë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Presidenti sërish u ka bërë thirrje partive politike t'i bashkohen procesit të dialogut dhe të kontribuojnë për arritjen e marrëveshjes finale me Serbinë



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 19 KORRIK - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë të enjten se bisedimet me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, janë shumë të vështira përderisa ai ende mendon se Kosova është zemër e Serbisë. Në një konferencë me gazetarë, Thaçi ka thënë se mentaliteti i Beogradit është larg realitetit. "Nuk është lehtë të bisedosh me serbin Aleksandar Vuçiq, i cili ende mendon se Kosova është pjesë e Serbisë. Do të thotë, një ëndërr e serbëve. Nuk është lehtë të bisedosh me një president serb që mendon se Kosova është zemra e Serbisë. Ky pozicion i presidentit Vuçiq është larg realitetit. Prandaj takimi i fundit në Bruksel ka qenë më i vështiri që nga fillimi i dialogut politik", është shprehur Thaçi, duke shtuar se qasja e Serbisë është problem për arritjen e një marrëveshje përfundimtare për normalizimin e raporteve, që për Kosovën nënkupton njohje reciproke si shtete të pavarura. Por, pavarësisht prej vështirësive dhe dallimeve të mëdha, ai ka thënë se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë në mënyrë që brenda gjashtë muajve të ardhshëm të arrihet marrëveshja finale për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. "Kosova është vend sovran e i pavarur dhe kushdo që vjen në pushtet në Serbi duhet ta ketë të qartë këtë. Pavarësisht prej vështirësive dhe dallimeve të mëdha, në takimin e fundit është potencuar që procesi duhet të vazhdojë në mënyrë që gjatë katër ose gjashtë muajve të ardhshëm të arrihet marrëveshja finale për normalizimin e marrëdhënieve dhe njohjes reciproke", ka theksuar Thaçi, duke shtuar se arritja e kësaj marrëveshje është në interesin e të gjithëve. "Duhet të punojmë për marrëveshjen përfundimtare sepse është në interesin e dy popujve dhe vendeve tona. Ne të dy presidentët e kemi të qartë se pa një normalizim, rreziku për tensione e konflikte të reja mbetet i hapur. Ne po punojmë që kjo situatë mos të kuptohet si betejë për ta mundur njëri-tjetrin, Kosova dhe Serbia, por që marrëveshja të rezultojë e dinjitetshme dhe fituese për të dy vendet. Në Bruksel kemi shprehur përkushtimin se Kosova është në favor të dialogut, të negociatave me Serbinë, në të njëjtën kohë kemi thënë se ky proces duhet të përmbyllet me njohje formale nga Serbia për Kosovën, dhe me anëtarësimin e Kosovës në të gjitha organizatat ndërkombëtare", ka thënë ai. Sipas Thaçit, të gjithë janë të vetëdijshëm se normalizimi i raporteve Kosovë - Serbi, ndërtimi i fqinjësisë së mirë dhe njohja reciproke paraqet paqe, stabilitet dhe të ardhme të sigurt evropiane për të dy vendet dhe për gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. "Pozicioni i Prishtinës është i qartë: marrëveshja përfundimtare duhet të jetë në mes dy vendeve sovrane. Tash flitet për kompromis, por Kosova ka ardhur në këtë realitet të pavarësisë dhe sovranitetit në përputhshmëri me dokumentin e presidentit Ahtisari, duke bërë kompromise në Rambuje, në Vjenë apo edhe në fazat e mëvonshme. Për Kosovën fitorja më e madhe është përshpejtimi i procesit drejt NATO-s dhe BE-së", ka deklaruar Thaçi, duke shtuar se në javët dhe muajt në vazhdim procesi i dialogut të vazhdojë në mënyrë më dinamike dhe me hapa më konkretë deri tek arritja e marrëveshjes përfundimtare. "Arritja e marrëveshjes përfundimtare është fitore e BE-së dhe është disfatë e ideologjive joperëndimore. Nëse nuk arrihet marrëveshja ideologjitë joperëndimore do ta shfrytëzojnë atë gjendje në mënyrë të tmerrshme dhe në dëm të vlerave demokratike. E di se ka zëra kritikë nga të gjitha anët, por marrëveshja është në interesin e të gjithëve", ka theksuar presidenti Thaçi. Edhe një herë shefi i shtetit u ka bërë thirrje partive politike t'i bashkohen procesit të dialogut dhe të kontribuojnë për arritjen e marrëveshje finale me Serbinë, e cila, sipas tij, do t'i hapte rrugën Kosovës për anëtarësim në Kombet e Bashkuara, në të ardhmen edhe në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

## Brenda katër muajve do të përmbyllet procesi i liberalizimit të vizave

Presidenti i Republikës Kosovës, Hashim Thaçi, ka përgëzuar qytetarët për rekomandimin e Komisionit Evropian për liberalizim të vizave. Ai ka thënë se liberalizimi i vizave është i pandalshëm. Në këtë kontekst, Thaçi ka theksuar se brenda trekatër muajve do të përmbyllet ky proces. "Do ta nisim kampanjën për procesin e vizave. Të enjten kam takuar përfaqësuesit e sistemit gjyqësor të cilët i kam përgëzuar për punën në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Po ashtu, kam kërkuar nga ta ta vazhdojnë punën në këtë drejtim", është shprehur presidenti Thaçi.

# Ambasadori Cufaj dorëzoi kredencialet te presidenti i Gjermanisë

BERLIN, 19 KORRIK (ER) - Ambasadori i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Kosovës në Republikën Federale të Gjermanisë, Beqë Cufaj, ka dorëzuar kredencialet tek presidenti i Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier.

Ambasadori Cufaj, i shoqëruar nga bashkëshortja dhe dy vajzat, si dhe koloneli i FSK-së, Xhavit Sadriaj, këshilltari Lulëzim Pllana dhe zëvendëskonsullja Leonita Harxhi, janë pritur nga Garda e Nderit e Republikës Federale të Gjermanisë dhe në praninë e medieve, si dhe nën përcjelljen e bashkëpunëtorëve të presidentit të Gjermanisë, Steinmeier.

Pasi ka kryer procedurën e paraparë, në takimin me presidentin e Gjermanisë dhe pasi i ka përcjellë përshëndetjet e presidentit, kryeministrit dhe krerëve të tjerë të shtetit të Kosovës, ka falënderuar presidentin Steinmeier për angazhimin e tij prej më se 20 vjetësh në të gjitha funksionet për Kosovën dhe qytetarët e saj.



Flet për "Epokën e re", Blerta Deliu-Kodra

# Procesi i liberalizimit të viza

## - Kosova do të ketë dinamikë të re të lobimit për liberalizimin e vizave te vendet e BE-së



Kryetarja e Komisionit për Integrime Evropiane në Kuvendin e Kosovës, Blerta Deliu-Kodra, ka vlerësuar se rekomandimi për heqjen e vizave për Kosovën paraqet një çast të rëndësishëm për realizimin e një të drejte të shumëpritur. Duke u bazuar në përmbushjen e kritereve dhe takimet me përfaqësuesit e BE-së, ajo ka shprehur optimizëm se procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës do të përfundojë këtë vit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Deliu-Kodra ka theksuar se aprovimi i vendimit për vizat do të jetë më i lehtë në Parlamentin Evropian, ndërsa më kompleks në Këshillin e Ministrave. Ajo ka paralajmëruar se institucionet e Kosovës do ta kenë një dinamikë të re të lobimit për liberalizimin e vizave për t'i bindur vendet anëtare të BE-së se kosovarët nuk do ta keqpërdorin këtë proces

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**Prishtinë, 19 korrik** - Kryetarja e Komisionit për Integrime Evropiane në Kuvendin e Kosovës, Blerta Deliu-Kodra, ka thënë të enjten se procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës do të përfundojë këtë vit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka bërë me dije se aprovimi i rekomandimit për vizat do të jetë më i lehtë në Parlamentin Evropian, ndërsa më kompleks në Këshillin e Ministrave. "Dhënia e një date të saktë për këtë proces do të ishte një paragjykim i vendimmarrjes së dy institucioneve të Bashkimit Evropian, pasi ky proces është i tëri vullnet politik i anëtarëve të Parlamentit Evropian dhe përfaqësuesve të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Por, bazuar në përmbushjen e të gjitha kritereve dhe bazuar në takimet tona të ndryshme që kemi pasur me përfaqësues të institucioneve të BE-së shpresojmë se ky proces të përfundojë gjatë këtij viti", ka deklaruar Deliu-Kodra.

Ajo ka paralajmëruar se institucionet e Kosovës do ta kenë një dinamikë të re të lobimit për liberalizimin e vizave për t'i bindur vendet anëtare të BE-së se janë plotësuar kushtet dhe se kosovarët nuk do ta keqpërdorin liberalizimin. "Pra puna, përpjekjet tona dhe mobilizimi vazhdojnë edhe pas rekomandimit pozitiv nga Komisioni Evropian, më lejoni ta quaj në zhargonin futbollistik, tashmë jemi në finale, ku më shumë se kurrë ne duhet të jemi më dinamikë në procesin e lobimit dhe prezantimit të punës sonë tek të gjithë aktorët e procesit vendimmarrës. Prandaj komisioni do të ketë edhe një dinamikë të re të lobimit edhe në këtë fazë. Përveç kësaj, institucionet tona duhet ta vazhdojnë kampanjën për vetëdijesimin e qytetarëve me të drejtat dhe përgjegjësit nga procesi i liberalizimit", është shprehur Deliu-Kodra, duke shtuar se Kuvendi ka prioritet kombëtar agjendën e integrimeve evropiane. "Bazuar në këtë prioritet të përbashkët kombëtar nuk e shoh si problem apo nuk do të duhej të ishte problem konsensusi nacional sa iu përket temave që ndërlidhen me agjendën e integrimit evropian. Agjenda evropiane ngërthen në vete edhe miratimin e legjislacionit që drejtpërdrejt ndërlidhen me këtë agjendë dhe mosmiratimi i këtyre ligjeve do ta ngadalësonte dinamikën e procesit të integrimit evropian", ka theksuar ajo.

Sa i përket fazës finale të dialogut me Serbinë, deputetja Deliu-Kodra ka thënë se ka rëndësi të veçantë për të ardhmen e vendit. Ajo ka bërë me dije se Kuvendi do të ketë rol të rëndësishëm në këtë proces, sidomos kur kemi parasysh faktin se marrëveshja do të ratifikohet në Kuvend. "Partitë politike, e sidomos partitë opozitare, duhet të bëhen pjesë e dialogut, meqë në procesin final përfshirja e opozitës është e nevojshme dhe bojkotimi i opozitës nga një proces i tillë nuk është zgjidhje", ka thënë Deliu-Kodra.

**"Epoka e re":** *Znj. Deliu-Kodra, tashmë Komisioni Evropian ka rekomanduar heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës por, megjithatë, ende ka procedura deri në fazën finale kur mund të udhëtohet pa viza. Besoni se ky vendim do të miratohet edhe nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Ministrave?*

**Deliu-Kodra:** Komisionari i Migracionit dhe Çështjeve të Brendshme, z. Avramopoulos, të mërkurën konfirmoi se Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret e caktuara për liberalizimin e vizave. Ky rekomandim për qytetarët e Kosovës dhe institucionet e Kosovës paraqet një moment të rëndësishëm për realizimin e një të drejte të shumëpritur për udhëtim të lirë dhe pa viza në shtetet e Zonës Shengen. Me të drejtë potencuat se ende ka procedura deri në fazën finale dhe rekomandimi pozitiv i dhënë nga Komisioni Evropian paraqet fazën e parë në këtë proces. Dy institucionet vendimmarrëse të Bashkimit Evropian, Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, duhet ta vendosin (konfirmojnë) qëndrimin e Komisionit Evropian, ku procedura vendimmarrëse në Parlamentin Evropian për këtë proces është më lehtë e realizueshme sesa ajo në Këshillin e BE-së, ku vendimmarrja është më komplekse. Bazuar në këtë dhe duke pasur parasysh qëndrimin e shprehur publikisht nga europarlamentarët, besojmë se ky vendim do të miratohet brenda vitit në Parlamentin Evropian,

# ve do të përfundojë këtë vit



ndërsa shpresojmë se edhe Këshilli do ta miratojë këtë vendim.

**"Epoka e re":** *Kur do të mund të hyjë në fuqi ky vendim, pra qytetarët të udhëtojë pa viza në Zonën Shengen?*

**Deliu-Kodra:** Dhënia e një date të saktë për këtë proces do të ishte një paragjykim i vendimmarrjes së dy institucioneve të Bashkimit Evropian, pasi ky proces është i tëri vullnet politik i anëtarëve të Parlamentit Evropian dhe përfaqësuesve të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Por, bazuar në përmbushjen e të gjitha kritereve dhe bazuar në takimet tona të ndryshme që kemi pasur me përfaqësues të institucioneve të BE-së, shpresojmë se ky proces të përfundojë gjatë këtij viti.

**"Epoka e re":** *Ju si komision dhe si Kuvend, përfshirë pozitën dhe opozitën, a keni ndonjë strategji për të lobuar tek institucionet e BE-së që kjo çështje të përfundojë me sukses, pra të mos anashkalohet apo të lihet për vitin tjetër?*

Deliu-Kodra: Duke pasur parasysh rëndësinë e lobimit tek institucionet e Bashkimit Evropian për përfundimin e procesit të liberalizimit gjatë këtij viti, Kuvendi ka krijuar një grup të përbërë nga deputetë/përfaqësues të partive politike me qëllim të lobimit te shtetet anëtare të Zonës Shengen, grup ky i udhëhequr nga kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, që ka për qëllim prezantimin e punës sonë institucionale dhe, po ashtu, lobimin për t'i bindur shtetet anëtare se qytetarët e vendit tonë meritojnë të lëvizin lirshëm. Ndërsa në cilësinë e kryetares së Komisionit për Integrime Evropiane dhe me anëtarët e tjerë të këtij komisioni kemi zhvilluar takime dhe do të vazhdojmë të kemi takime me përfaqësues të ndryshëm, ambasadorë të akredituar në Prishtinë, nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve të Bashkimit Evropian, me qëllim të prezantimit të punës sonë për përmbushjen e të gjitha kritereve për liberalizimin e vizave, por jo vetëm, por edhe të përpjekjeve të vazhdueshme me qëllim të avancimit të agjendës sonë evropiane në përgjithësi. Pra, puna, përpjekjet tona dhe mobilizimi vazhdojnë edhe pas rekomandimit pozitiv nga Komisioni Evropian, më lejoni ta quaj në zhargonin futbollistik, tashmë jemi në finale, ku më shumë se kurrë ne duhet të jemi më dinamikë në procesin e lobimit dhe prezantimit të punës sonë tek të gjithë aktorët e procesit vendimmarrës. Prandaj komisioni do të ketë edhe një dinamike të re të lobimit edhe në këtë fazë. Përveç kësaj, institucionet tona duhet ta vazhdojnë kampanjën për vetëdijesimin e qytetarëve me të drejtat dhe përgjegjësit nga procesi i liberalizimit.

**"Epoka e re":** *Si e vlerësoni punën e Kuvendit në përgjithësi, në veçanti përmbushjen e obligimeve të agjendës evropiane? Deri më tani po ka problem në funksionimin e Kuvendit për shkak të mungesës së kuorumit. Edhe sa mund të vazhdohet kështu?*

**Deliu-Kodra:** Me të gjitha sfidat e veta që ka bartur ky proces, Kuvendi më në fund arriti ta tejkalojë suksesshëm përmbushjen e kriterit të vetëm të mbetur sa i përket procesit të liberalizimit të vizave. Partitë politike në përgjithësi, edhe Kuvendi në veçanti, ka prioritet kombëtar agjendën e integrimeve evropiane. Bazuar në këtë prioritet të përbashkët kombëtar, nuk e shoh si problem, apo nuk do të duhej të ishte problem konsensusi nacional sa iu përket temave që ndërlidhen me agjendën e integrimit evropian. Agjenda evropiane ngërthen në vete edhe miratimin e legjislacionit që drejtpërdrejt ndërlidhen me këtë agjendë dhe mosmiratimi i këtyre ligjeve do ta ngadalësonte dinamikën e procesit të integrimit evropian.

**"Epoka e re":** *Znj. Deliu-Kodra, dialogu për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë ka hyrë në fazën finale. Cili do të jetë roli i Kuvendit në këtë proces, dhe a do të mund të arrihet përkrahja e opozitës?*

**Deliu-Kodra:** Faza e fundit e dialogut ka peshën e vet dhe, si e tillë, është e një rëndësie të veçantë për të ardhmen e vendit. Kuvendi pa dyshim se do të ketë rol të rëndësishëm në këtë proces, sidomos kur kemi parasysh faktin se marrëveshja do të ratifikohet në Kuvend. Partitë politike, e sidomos partitë opozitare, duhet të bëhen pjesë e dialogut, meqë në procesin final përfshirja e opozitës është e nevojshme dhe bojkotimi i opozitës nga një proces i tillë nuk është zgjidhje.



# Ministri Tahiri: Do ta rrisim efikasitetin e gjyqësorit




PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, i shoqëruar nga kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nehat Idrizi dhe kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, kanë vizituar të enjten Gjykatën Themelore në Prishtinë, ku janë pritur në takim nga kryetarja e kësaj Gjykate, Afërdita Bytyçi.

Ministri Tahiri ka theksuar se vizita ka të bëjë me raportin pozitiv nga Komisioni Evropian për përmbushjen e të gjitha kushteve për liberalizimin e vizave, meqenëse Gjykata Themelore e Prishtinës ka bartur barrën kryesore në procesin e rasteve të shënjëstruara. "Kemi ardhur sot t'i falënderojmë, që punën e gjyqësorit po e sjellin në një standard të ri, në një dimension të ri. Jam shumë i lumtur që tani e tutje vetëm sa do ta rrisim efikasitetin e gjyqësorit", ka thënë Tahiri.

Ministri Tahiri ka theksuar se ky raport pozitiv është shtysë e madhe që të punohet më tutje që gjyqësori t'i plotësojë pritjet dhe kërkesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës. "Ne nuk do të vetëkënaqemi. Edhe më tutje do të angazhohemi që të kemi një gjyqësor sa më profesional, sa më efikas, në përputhje të plotë me pritjet dhe kërkesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës", është shprehur ministri Tahiri.

Ndërkaq kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi, ka bërë me dije se raporti i KE-së ka motivuar gjyqësorin që lëndët e kësaj natyre të trajtohen me prioritet edhe në të ardhmen, ndërsa kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, ka potencuar rëndësinë që ka bashkëpunimi mes institucioneve në të mirë të interesit të qytetarëve.

# Haradinaj, studentëve të huaj: Duke vizituar Kosovën, mësoni të vërtetën tonë

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim një grup prej 64 studentëve, nga 31 shtete të ndryshme të botës, pjesëmarrës të Akademisë Verore Ndërkombëtare në Kosovë, organizuar nga Qendra Kosovare për Diplomaci në bashkëpunim me Kolegjin Universum



EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 19 KORRIK - Kryeministri Ramush Haradinaj në një takim me studentët ka theksuar se arsyeja pse Kosova ka qenë shumë me fat është trajtimi i mirë që i është bërë nga shumë shtete të botës. "Kosova është ndihmuar në kohën e krizës dhe në vazhdimësi nga shumë vende, madje edhe në ditët e sotme. Qeveria që unë drejtoj ka një qasje për ta përfunduar listën e punëve të shtëpisë, listën e gjërave që duhet bërë për ta përmirësuar jetën e qytetarëve. Kjo është ajo në të cilën jam fokusuar. Disa rezultate tashmë po i shohim, por kemi ende sfida para nesh", ka thënë Haradinaj.

Para studentëve, ai ka theksuar synimin që Kosova t'i bashkohet familjes së kombeve, të jetë anëtare e OKB-së, pjesë e familjes evropiane, NATO-s, duke shpresuar për marrëdhënie të mira bilaterale me secilin vend në botë. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj është përgjigjur në pyetjet e studentëve lidhur me rekomandimin pozitiv të liberalizimit të vizave. "Evropa dje ka çliruar qytetarët e vet. Ne jemi evropianë. Fakti që na është njohur se kemi përmbushur të gjitha kushtet, është sukses i Evropës. Me këtë privilegj vijnë obligime shtesë dhe unë jam i bindur se do t'i përmbyllim obligimet tona në këtë proces. Mirëpresim rekomandimin e djeshëm dhe besojmë se përmes Kuvendit dhe shteteve individuale do të korrim sukses në këtë rrugëtim. Edhe shtetet tuaja kanë vlerësuar se ne si Kosovë po i kryejmë detyrat e shtëpisë", ka thënë Haradinaj.

Po ashtu, kryeministri është përgjigjur edhe në pyetjet e tjera të studentëve që kryesisht kishin të bënin me investimet e huaja në Kosovë, zhvillimin ekonomik, rininë dhe të ardhmen e tyre, si dhe integrimin në BE, duke rikonfirmuar qëndrimin se Kosova ka orientim euroatlantik.

Kryeministri Haradinaj ka folur edhe për të kaluarën e hidhur, duke thënë se Kosova ka ende çështje të hapura që duhet të mbyllen. "Për t'i përfunduar këto çështje, është mirë të jemi ekip. Shpresojmë se Evropa, ShBA-ja dhe shtete të tjera do të na ndihmojnë t'i mbyllim të gjitha çështjet e hapura në këtë pjesë të botës. Por, Evropa ka një rol të rëndësishëm dhe mund të bëjë shumë në këtë drejtim", ka thënë Haradinaj. Në këtë diskutim me studentë, kryeministri Haradinaj ka theksuar përkushtimin e Qeverisë për zhvillimin ekonomik, si një ndër faktorët më të rëndësishëm për fuqizimin e vendit. "Duam të përçojmë një mesazh dhe t'i inkurajojmë sipërmarrësit. Pra, ju lutem, investoni në Kosovë dhe na vizitoni, sepse ushqimi ynë, mikpritja, vendi dhe njerëzit tanë janë shumë të jashtëzakonshëm. Duke vizituar Kosovën do ta mësoni të vërtetën tonë", ka deklaruar Haradinaj.




# ORCA: Supermenët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike

PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) është duke monitoruar procesin aktual të avancimeve akademike në Universitetin e Prishtinës. "Disa nga kandidatët e këtij procesi të cilët të hënën do të votohen për avancim, kemi parë se kanë bërë punë të jashtëzakonshme. Duke na lënë edhe neve të habitur, kemi parë se 10 kandidatë të propozuar për avancime nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike kanë publikuar 5 deri 19 artikuj secili në revista shkencore brenda një viti e gjysmë. Mesatarja e numrit të publikimeve për kandidatin e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike për një vit del 5.5, ndërsa sipas një studimi të botuar në revistë ndërkombëtare, del se në Norvegji në fushën e njëjtë ka 0.96 publikime shkencore në vit për profesor", është theksuar në njoftimin e ORCA-së.

Nga kjo situatë ORCA ka bërë me dije se mund të nxjerrin vetëm dy përfundime. "1. Ose Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i ka tejkaluar pesëfish performancat akademike norvegjeze për sa iu përket publikimeve shkencore; 2. Ose publikimet shkencore të FIM nuk janë në revista me cilësi të pranueshme ndërkombëtare", është thënë në këtë njoftim.

ORCA ka shtuar se ndonëse publikimet e këtyre kandidatëve i plotësojnë kriteret minimale sasiore sipas rregullativave në fuqi, revistat ku janë botuar ato lënë hapësirë për dyshim. "Shumica e këtyre publikimeve janë bërë në vetëm tri revista. Për këto tri revista ORCA ka zbuluar se: keqinformojnë për indeksimin e tyre, përmendin indeksim në databaza të shuara që një kohë të gjatë, nuk e tregojnë adresën e tyre, keqinformojnë për përdorimin e softuerit antiplagjiaturë, ndërkohë që është e lehtë të gjendet plagjiat nga Wikipedia në publikimet e tyre. Për më tepër, një nga këto revista e ka botuesin të listuar si të dyshimtë dhe me shkelje serioze të Parimeve të Transparencës dhe Praktikave të Mira për Botues Shkencor. Ne i bëjmë thirrje Senatit që, pavarësisht prej përmbushjes formale të kritereve, ta zbatojë detyrën e tij statutare, pra të sigurohet se cilësia është mbrojtur duke zbatuar standardet e pranuara botërisht", është thënë në njoftimin e ORCA-së.

# MPB-ja mirëpret raportin e Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave

Prishtinë, 19 korrik (ER) - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka mirëpritur raportin e Komisionit Evropian rreth përmbushjes së kritereve të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave. Ministria e Punëve të Brendshme ka përshëndetur lajmin se Republika e Kosovës ka përmbushur të gjitha kriteret e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. "Tashmë pritet që propozimi i Komisionit Evropian për heqjen e vizave të miratohet së shpejti nga Këshilli dhe Parlamenti Evropian. Falënderojmë zyrtarët e MPB-së dhe agjencive të saj, që në mënyrë profesionale, të palodhshme dhe të përkushtuar, janë angazhuar për t'i përmbushur 70 nga 95 kriteret e udhërrëfyesit për liberalizim të vizave për të cilat MPB ishte përgjegjëse", është thënë në komunikatën e MPB-së. Sipas MPB-së, bashkëpunimi me institucionet e tjera të Qeverisë së Kosovës, partnerët ndërkombëtarë dhe me qytetarët gjatë këtij procesi, ka luajtur rol kyç dhe kështu do të vazhdojë edhe më tej me qëllim të përfundimit me sukses të këtij procesi jetik për lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës. "Ministria e Punëve të Brendshme do të mbetet e përkushtuar për menaxhimin efikas të procesit pas liberalizimit të vizave dhe siguron të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, se do të njoftohen me kohë rreth të gjitha të drejtave dhe obligimeve që dalin nga lëvizja e lirë në Zonën Shengen", është theksuar në këtë komunikatë.



# LDK-ja kërkon zgjedhje të parakohshme

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka përsëritur të enjten kërkesën e kësaj partie se vendi nuk mund të qeveriset nga koalicioni i pakicës i cili nuk ka legjitimitet. "Vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja që të mos dëmtohet demokracia", ka thënë Hoti




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka vlerësuar se vendi nuk mund të qeveriset nga një koalicion i pakicës. Shefi i grupit parlamentar i kësaj partie, Avdullah Hoti, ka kërkuar që Kosova të shkojë në zgjedhje të reja parlamentare. "Seanca e Kuvendit të Kosovës sot u ndërpre në mungesë të shumicës parlamentare. Në fakt, ky koalicion asnjëherë nuk ka pasur shumicë në Kuvendin e Kosovës, përveç ditës kur u zgjodh Qeveria. Vendi nuk mund të qeveriset nga koalicioni i pakicës, i cili nuk ka legjitimitet. Grupi parlamentar i LDK-së nuk do ta përkrahë vazhdimin e kësaj forme të qeverisjes, ku një pakicë ka uzurpuar institucionet shtetërore. Vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja që të mos dëmtohet demokracia", ka thënë Hoti. Sipas tij, gjuha e ashpër dhe fyese e koalicionit të pakicës ndaj partive opozitare e thellon më tutje krizën institucionale. "Ne ftojmë për përgjegjësi politike dhe institucionale nga të gjithë. Ne do të punojmë me të gjitha forcat politike opozitare dhe forcat e tjera progresive në Kuvendin e Kosovës që të dalim nga kjo krizë institucionale, vetëm përmes organizimit të zgjedhjeve të lira. Insistimi për të vazhduar me këtë dhunim të demokracisë do t'i dëmtojë proceset afatgjata politike në Kosovë", është shprehur Hoti.

# Rektori Dema shprehet i kënaqur me përgatitjet rreth organizimit të provimit



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 KORRIK - Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", prof. dr. Marjan Dema, ka vizituar të enjten njësitë akademike ku janë mbajtur provimet pranuese për kandidatët për studentë të rinj të UP-së. Rektori Dema gjatë kësaj vizite ishte i shoqëruar nga bashkëpunëtorët: prorektorja për buxhet dhe financa në UP, prof. dr. Myrvete Badivuku, prorektorja për bashkëpunim ndërkombëtar, prof. asoc. dr. Merita Berisha, si dhe këshilltari i tij, prof. Rrustem Qehaja. Në fjalën drejtuar të pranishmëve, rektori Dema u shpreh i kënaqur me përgatitjet që janë bërë rreth organizimit të këtij provimi.

Ai u dëshiroi suksese kandidatëve teksa u premtoi se pjesë e universitetit më të madh në vend do të jenë kandidatët më të mirë. "Ky universitet është kaq madhështor falë faktit se çdoherë në këto porta kanë hyrë studentë të cilët kanë arritur të bëhen të mëdhenj në karrierën e tyre. Ata me njohuritë e fituara i kanë shërbyer vetes, familjes, kombit dhe komunitetit në përgjithësi", ka thënë Dema.

Gjithashtu, rektori Dema ka inkurajuar kandidatët që punojnë drejt arritjes së synimeve të tyre. "Rrugët e vështira janë çdoherë ato që ju dërgojnë tek vendet më të bukura. Andaj, shpresoj se ky udhëtim i nisur sot të mos përfundojë këtu, por të ketë fundin tek realizimi i synimeve tuaja, duke u aftësuar për profesionin që tashmë keni zgjedhur", është shprehur Dema.

Ndërsa dekanët e njësive akademike si dhe profesorët mbikëqyrës e informuan rektorin Dema se gjithçka rreth organizimit të provimeve pranuese po shkon sipas planifikimit dhe se nuk është raportuar ndonjë pakënaqësi nga ana e kandidatëve.

Universiteti i Prishtinës në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik 2018/2019, do të regjistrojë 7 066 studentë, prej të cilëve 6 156 studentë të rregullt dhe 910 me korrespondencë.

# Ismaili: 70 për qind të barnave i kemi me kontrata

PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se furnizimi me barna esenciale është përmirësuar për faktin se tanimë 70 për qind të barnave janë me kontrata. Këto komente Ismaili i ka bërë të enjten gjatë pranimit të pajisjeve mjekësore për Klinikën e Kardiokirurgjinë nga Ambasada e Italisë, pajisje këto që kapin shifrën 370 mijë euro. "370 mijë euro pajisje për Klinikën e Kardiokirurgjisë, të cilat mundësojnë vënien në funksion edhe të sallës së dytë operative për sëmundjet e zemrës dhe rritjen e numrit të shërbimeve. Donacioni nga Qeveria e Italisë për shëndetësinë e Kosovës është në kuadër të projektit tremilionësh 'Mbështetje për sistemin shëndetësor në Kosovë'. Pas heqjes së listës së pritjes për stentim, tani kjo klinikë do të jetë edhe më e gatshme për pacientët tanë që t'u shërbejë të gjithëve pa dallim dhe pa pasur nevojë të presin", ka thënë Ismaili.

Ai ka theksuar se kanë arritur ta përmirësojnë gjendjen e furnizimit me barna, si dhe kanë arritur të kursejnë miliona euro duke mos blerë barna me çmime të larta ashtu siç ka ndodhur deri tani.



# Kosova dhe Shqipëria diskutojnë për përshpejtimin e hapave për heqjen e Roamingut

PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë janë zotuar për hapa të domosdoshëm që duhet të ndërmarrin në aspekt legjislativ dhe teknik, me qëllim që të përshpejtohen procedurat në mënyrë që në afatin më të shkurtër të mundshëm të hiqet Roamingu mes dy vendeve.

Në këtë linjë ishte takimi i delegacioneve nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Kosovës, i kryesuar nga ministri Valdrin Lluka dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Shqipërisë, i prirë nga zëvendësministrja Dorina Çinari, ku mori pjesë edhe sponsoruesi i rezolutës së Kuvendit të Kosovës për heqje të Roamingut, deputeti Dardan Molliqaj, si dhe kryetari i ARKEP-it, Kreshnik Gashi.

Në takim u shqyrtuan edhe mundësitë që operatorët të bëjnë marrëveshje në mes vete që së paku për këtë sezon të pilotohet heqja e Roamingut, pastaj të nënshkruhen marrëveshjet e domosdoshme ndërshtetërore në mes të ministrive dhe marrëveshjet teknike në mes të 2 rregullatorëve të komunikimeve elektronike të dy vendeve tona.

Heqja e Roamingut është një nga shërbimet më të rëndësishme që do t'u mundësojë qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës dhe Shqipërisë komunikim shumë më efikas dhe më të Lirë. Me këtë rast u theksua se shumë shpejt tarifat e Roamingut në mes të Kosovës dhe Shqipërisë do të jenë temë e së kaluarës.



# Nënshkruhet marrëveshje për riintegrimin ekonomik të personave të riatdhesuar

PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), nënshkruan të enjten marrëveshje bashkëpunimi në fushën e riintegrimit ekonomik të personave të riatdhesuar në tregun e punës.

Marrëveshja u nënshkrua nga ministri i MPMS-së, Skender Reçica, ministri i MPB-së, Bejtush Gashi dhe përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së në Kosovë, Ulrika Richardson. Me anë të kësaj marrëveshje do të mbështeten personat e riatdhesuar duke u ofruar mundësi në trajnim, punësim dhe krijim të bizneseve të reja dhe ofrim të shërbimeve të konsulencës, në kuadër të Programit Aktiv për Tregun e Punës në Kosovë.




Kësaj marrëveshje i ka paraprirë marrëveshja ndërministrore e nënshkruar në muajin maj të këtij viti në mes të MPMS-së dhe MPB-së, rreth transferimit të kompetencave në fushën e riintegrimit ekonomik nga MPB-ja në MPMS.

Ky projekt do të realizohet nga MPMS-ja në bashkëpunim me UNDP-në gjatë periudhës 2019-2021 dhe në bazë të marrëveshjes, pritet të përfitojnë më shumë se 1 250 persona të riatdhesuar duke u ofruar mundësi të trajnimit, punësimit dhe krijimi të bizneseve të reja.

Qëllimi i këtij projekti është riintegrimi i qëndrueshëm ekonomik i familjeve të riatdhesuara si një nga kriteret për liberalizim të vizave dhe integrimeve euroatlantike përmes dhënies së mundësisë së trajnimit, punësimit dhe hapjes së bizneseve të reja përmes programeve aktive të tregut të punës, për persona të riatdhesuar, në përputhje me politikat e riintegrimit të personave të riatdhesuar në tregun e punës dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

# AKB-ja: Mbi 60 milionë euro bizneset dhe qytetarët shpenzuan për viza

PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka përshëndetur rekomandimin pozitiv të Komisionit Evropian për liberalizmin e vizave për qytetarët e Kosovës. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se humbjet e bizneseve dhe qytetarëve që nga viti 2016 e këndej kapin vlerën rreth 60 milionë euro, të cilat, sipas tij, kanë mundur të evitohen me punën më të përgjegjshme të institucioneve të Kosovës për t'i përmbushur kushtet dhe kriteret të cilat padrejtësisht BE-ja ia pati rekomanduar Kosovës. "Liberalizimin e vizave, për të cilën ende nuk kemi datë se kur do të fillojë së zbatuari, ne nuk duhet ta marrim si privilegj për kosovarët, por si një barazi e vonuar me vendet e Ballkanit, për të cilën Kosova ishte i vetmi vend i izoluar. Për vonesat rreth liberalizimit të vizave bizneset dhe qytetarët duhet ta kërkojnë përgjegjësinë në institucionet e vendit, për të cilat i kemi votuar dhe mandatuar me votë. Pra, bizneset kërkojnë përgjegjësi për vonesa dhe humbje milionëshe për shkak të izolimit që neve na është bërë padrejtësisht nga BE-ja, por gjithmonë është adresuar përgjegjësia për mospërmbushje të kritereve për liberalizim të vizave në drejtim të institucioneve të Kosovës", është thënë në komunikatën e AKB-së. Sipas kësaj komunikate, me liberalizimin e vizave vendi ynë do t'i kursejë mbi 20 milionë euro të shpenzuara në baza vjetore. "Shpresojmë se në vitin e ardhshëm bizneseve dhe qytetarëve të Kosovës do t'u hapet perspektiva e re për të lëvizur lirshëm për biznes, studime, aktivitete kulturore dhe sportive, për të bërë vizita familjare, por edhe për të kryer shërbime shëndetësore për të cilat qytetarët kanë vuajtur




për mungesë të vizave. Vendi ynë do t'i kursejë mbi 20 milionë euro të shpenzuara në baza vjetore për t'i marrë vizat për biznese", është thënë në komunikatën e AKB-së.

# Haradinaj i ofron përkrahje OEK-ut



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vizituar të enjten Odën Ekonomike të Kosovës (OEK), ku është takuar me kryetarin Berat Rukiqi dhe me bashkëpunëtorët e tij. Gjatë takimit me të, kryeministri Haradinaj ka shprehur gatishmërinë për t'ua ofruar ndihmën e nevojshme bizneseve dhe prodhuesve në mënyrë që Kosova të forcohet ekonomikisht

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vizituar të enjten Odën Ekonomike të Kosovës OEK), ku është takuar me kryetarin e ri të kësaj ode, Berat Rukiqi. Kryeministri Haradinaj ka përgëzuar kryetarin për marrjen e detyrës për të udhëhequr Odën Ekonomike të Kosovës, duke theksuar se të gjithë aktorët që kanë përgjegjësi dhe peshë në mundësinë e rritjes ekonomike janë të vlefshëm, duke i ofruar partneritet bashkëpunimi këtij institucioni, në të mirë të zhvillimit ekonomik të vendit. "Si Qeveri e vendit, e konsiderojmë Odën Ekonomike partnere. Jemi të hapur të bashkëpunojmë dhe t'i marrim të gjitha propozimet e mundshme që ta ndihmojmë biznesin, sipërmarrësit, prodhuesit dhe që Kosova të ecë përpara në rritjen ekonomike", ka thënë Haradinaj.

Pas takimit, Haradinaj në një konferencë për medie ka thënë se vizita e tij lidhet me marrjen e përgjegjësisë së re nga Rukiqi. "Është përgjegjësi me peshë për mundësinë e rritjes së zhvillimit të vendit. U fol për liberalizimin e vizave që do të ndikojë në qarkullimin e mallrave. Dëshiroj të flas për zona ekonomike, pasi ka skeptikë, por duhet ta dimë se kush merr iniciativë ka sukses. Disa nga këto zona i konsiderojmë me rëndësi siç është Zona Ekonomike Amerikane", ka thënë Haradinaj.

Ai ka shtuar se Qeveria e Kosovës ka iniciativë, siç është rasti me krijimin e zonave ekonomike, me theks të veçantë për Zonën e Veçantë Ekonomike Amerikane dhe Parkun Inovativ Trajnues Kosovar-Gjerman. "Nëse jo të gjitha këto zona kanë sukses, ne i kemi dhënë mundësi zhvillimit ekonomik të vendit", ka deklaruar Haradinaj.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për partneritetin ofruar OEK-ut, që në mënyrë shumë të hapur dhe të drejtpërdrejtë t'i trajtojnë problemet dhe sfidat, por edhe propozimet që mund të avancojnë në sektorin privat. Haradinaj më pas ka zhvilluar një takim edhe me përfaqësues të bizneseve, nga të cilët u informua me vështirësitë që ballafaqohen ata. "Bizneset e Kosovës kanë qenë aleatët kryesorë të vendit për zhvillim ekonomik dhe kështu duhet të vazhdojë. Qeveria do të angazhohet që t'u ofrojë kushte dhe lehtësira në të bërit biznes", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ai ka folur edhe për procesin e liberalizimit të vizave, duke deklaruar se vetëm disa javë apo muaj e ndajnë Kosovën nga liberalizimi i vizave.

Ndërsa kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka falënderuar Haradinajn për punën e bërë dhe për rekomandim pozitiv për liberalizimin e vizave. Ai ka thënë se Haradinaj ka qenë aleat i biznesit. "Është koha të merremi me ekonomi, pas të gjitha atyre proceseve ekonomike që ka kaluar Kosova", është shprehur Rukiqi.

## Bëhet kategorizimi i rrugëve të Kosovës



PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka nënshkruar udhëzimin administrativ për përcaktimin e kritereve për kategorizimin e rrugëve. Me këtë rast, Lekaj ka thënë se me anë të këtij udhëzimi parashihet kategorizimin i rrugëve të reja apo ekzistuese për autoudhë, rrugë kombëtare dhe rrugë regjionale. Sipas ministrit Lekaj, deri më tani ky udhëzim administrativ nuk është zbatuar fare. Ai ka bërë me dije se tani e tutje do të nxirren në terren komisionet që do ta bëjnë rikategorizimin e rrugëve. "Nënshkrova udhëzimin administrativ mbi përcaktimin e kritereve dhe procedurave për kategorizimin e rrugëve. Ky udhëzim administrativ përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për kategorizimin e rrugëve të reja apo ekzistuese për autoudhë, Rrugë Nacionale (N) dhe Rrugë Regjionale (R)", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës.

# Komuna e Mitrovicës nënshkruan marrëveshje partneriteti me 'Save the Children'

MITROVICË, 19 KORRIK (ER) - Komuna e Mitrovicës, gjegjësisht Drejtoria Komunale e Arsimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Integrimeve Evropiane dhe Mirëqenies Sociale, kanë nënshkruar marrëveshjen e partneritetit me organizatën "Save the Children International" në Kosovë. Kjo marrëveshje u nënshkrua gjatë muajit korrik dhe është e mbështetur në bashkëpunimin mes SCI-së, DKA-së, DSh-së dhe DIEMS-së për realizimin e aktiviteteve specifike në kuadër të projektit "Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë në Kujdesin dhe Zhvillimin gjatë Fëmijërisë së Hershme në Kosovë" (KZhFH).

Palët e lartpërmendura e kanë lidhur këtë marrëveshje duke u bazuar në partneritetin e vazhdueshëm që kanë pasur dhe në frymën e parimeve të SCI-së për partneritet. Nëpërmjet kësaj marrëveshje parashihet angazhimi i dy edukatoreve parashkollore për shkollat: SFFMU "Aziz Sylejmani", paralele e ndarë në Suhodoll dhe ShFMU "Sefedin Smakolli" në Rashan.

Projekti do të vazhdojë të zbatohet edhe në ShMU "Sylejman Vokshi" në Broboniq, ShMU "Fazli Greiçevci", paralelja e ndarë në Vërnicë, ku parashihet ofrimi i një granti për ta mbështetur zbatimin e planit zhvillimor të këtyre dy qendrave të KZhFH-së.

Edhe për Institucionin Parashkollor "Gëzimi Ynë" në Mitrovicë do të ofrohet një grant për ta mbështetur zbatimin e planit zhvillimor të këtij institucioni.

Gjatë këtij muaji me organizatën "Save the Children International" në Kosovë është nënshkruar edhe marrëveshja tjetër e bashkëpunimit me Drejtorinë Komunale të Arsimit. Kjo marrëveshje është bërë me qëllim të bashkëpunimit në mes të SCI-së dhe DKA-së për realizimin e aktiviteteve specifike në kuadër të projektit për Arsimin Gjithëpërfshirës.

Nëpërmjet kësaj marrëveshje parashihet angazhimi i një mësimdhënësi të ri mbështetës gjithëpërfshirës në nivelin e Drejtorisë Komunale të Arsimit për të ofruar përkrahje të vazhdueshme për shkollat që do të përfshihen në grupin shkollor të komunës së Mitrovicës si dhe ofrimi i granteve të vogla për ta mbështetur zbatimin e planeve zhvillimore shkollore të grupeve të shkollave përfituese, të frymëzuara nga Indeksi për Gjithëpërfshirje.

Projekti do të zbatohet në pesë shkolla fillore: ShFMU "Migjeni", ShFMU "Bedri Gjinaj", ShFMU "Eqrem Çabej", ShFMU "Musa Hoti" në Mitrovicë dhe ShFMU "Bislim Imeri" në Kçiq të Madh.






# 'Kinemaja Lumbardhi' rikthehet në pronësi të Komunës së Prizrenit

PRIZREN, 19 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka bërë me dije se "Kinemaja Lumbardhi" është rikthyer në pronësi të kësaj komune. Ai ka thënë se për disa dekada "Kinemaja Lumbardhi" ka qenë hapësira kryesore për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe, mbase, lokacioni më i vizituar nga qytetarët e Prizrenit. "Në vitet '90 ka degraduar deri në mbyllje për shkak të zhvillimeve politike në vend. Pas luftës ka pasur përpjekje nga pushtetarët që të bëhet ndryshim i vendit të objektit, mirëpo falë përpjekjeve të shoqatave dhe organizatave të ndryshme për rifunksionalizim, kinemaja ka mbijetuar. Një ndër zotimet e mia ka qenë edhe rikthimi i 'Kinemasë Lumbardhi' në pronësi të qytetit, në mënyrë që Prizrenit t'ia kthejmë një hapësirë për zhvillimin e aktiviteteve kulturore. Lajm i mirë është se kërkesës së komunës për rikthimin e kësaj hapësire nga AKP-ja në pronësi të qytetit, Qeveria i është përgjigjur pozitivisht", ka thënë Haskuka. Ai ka thënë se qyteti i Prizrenit ka pasur nevojë për një hapësirë për organizimin e aktiviteteve kulturore. "Prizreni, pos të tjerash, njihet edhe me epitetin 'qytet i artit dhe i kulturës', prandaj është i domosdoshëm ta ketë një hapësirë reprezentative për organizimin e aktiviteteve kulturore. Komuna e Prizrenit dhe Fondacioni Lumbardhi falënderojnë të gjithë aktorët e përfshirë në plotësimin e kërkesës shumëvjeçare të qytetarëve të Prizrenit", është shprehur Haskuka.

# Komuna e Shtërpcës, ADA dhe UNDP hapin një ndërmarrje sociale të grave

SHTËRPCË, 19 KORRIK (ER) - Komuna e Shtërpcës, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) organizojnë sot (e premte) ceremoninë e hapjes së ndërmarrjes sociale "Shoqata e Pavarur e Grave Sevcë" në fshatin Sevcë, e cila do të mbahet në ambientet e Ndërmarrjes Sociale në fshatin Sevcë, Komuna e Shtërpcës, duke filluar nga ora 11:30.

Shoqata fillimisht u themelua në vitin 2016 dhe ka 40 anëtare që merren me përpunimin e frutave të ndryshme të kultivuara, si dhe bimëve aromatike dhe çajrave.




Përmes një granti dhe përkrahjes këshillimore të ofruar nga projekti Interdev 2, shoqata do të funksionojë si një ndërmarrje sociale dhe do t'i zgjerojë kapacitetet operacionale për ta mbështetur krijimin e vendeve të punës dhe gjenerimin e të ardhurave.

# Pezullohet nga puna punonjësi i laboratorit të QKMF-së në Ferizaj

FERIZAJ, 19 KORRIK (ER) - Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Ferizaj, Besnik Berisha, në ambientet e Barnatores së re Qendrore të QKMF-së ka prezantuar disa prej rezultateve të punës të kësaj drejtorie. Gjatë këtij prezantimi ai ka bërë me dije lajmin për pezullimin nga puna të punonjësit A. S. të laboratorit të QKMF-së në Ferizaj për dyshimet e marrjes së ryshfetit. Në këtë kontekst, Berisha ka inkurajuar qytetarët ferizajas t'i denoncojnë rastet e tilla të keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga ana e stafit shëndetësor. Ai ka theksuar se qeverisja e kryetarit Agim Aliu është e vendosur për luftimin e kësaj dukurie kudo në organet komunale.

Më tutje, ai ka thënë se janë shënuar edhe disa të arritura të tjera në fushën e shëndetësisë, siç është vendosja e kamerave në emergjencën primare, proces ky që do të shtrihet në të gjitha institucionet shëndetësore në Ferizaj si dhe zhvendosja e Barnatores Qendrore në objekt të ri, ku plotësohen kushtet e ruajtjes së produkteve farmaceutike sipas standardeve më të larta.



# Gjykata Themelore në Gjilan për gjashtë muaj ka zgjidhur mbi 8 000 lëndë

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

GJILAN, 19 KORRIK - Gjykata Themelore e Gjilanit në këtë gjashtëmujor ka treguar efikasitet për zgjidhjen e lëndëve, duke u dhënë përparësi lëndëve të korrupsionit dhe dhunës në familje. Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Ramiz Azizi, në një konferencë për media ka shpalosur të dhënat për këtë gjashtëmujor. Ai është ndalur te lëndët e korrupsionit, të cilave gjykata u ka dhënë rëndësi më shumë. "Gjatë këtyre gjashtë muajve kemi arritur t'i zgjidhim 19 lëndë të korrupsionit, ndërsa në punë kanë mbetur edhe 35 lëndë. Besoj se shumë shpejt numri i këtyre lëndëve do të zvogëlohet edhe më shumë, pasi janë lëndë me rëndësi. Dënimet për këto lëndë janë dënime me burg, me kusht, si dhe ka edhe aktgjykime liruese", ka thënë ai.
Gjykata Themelore e Gjilanit, së bashku me degët e veta në Viti, Kamenicë dhe Novobërdë, ka shënuar përparim për zgjidhjen e numrit të lëndëve. "Ky institucion në fillim të vitit ka trashëguar 20 331 lëndë, gjatë këtyre gjashtë muajve ka pranuar 6 571 lëndë, që do thotë se me numrin e lëndëve të trashëguara dhe atyre të pranuara ka gjithsejtë 26 902 lëndë. Gjatë kësaj periudhe kohore është arritur të zgjidhen 8 493, ndërkohë kanë mbetur në punë edhe 18 409 lëndë", ka thënë kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Ramiz Azizi.
Prej numrit të lëndëve të pranuara dhe atyre të kryera, efikasiteti është 129 për qind. Në bazë të këtij vlerësimi shihet edhe rënia e numrit të lëndëve nga 20 331 në 18 409. Në veçanti në Departamentin e Krimeve të Rënda janë trashëguar 308 lëndë nga vitet paraprake, kurse janë pranuar 137. Në total, 445 lëndë. Për gjashtë muaj janë kryer nga gjykatësit 147 lëndë, kanë mbetur edhe 298 lëndë në punë, kurse efikasiteti i kryerjes së lëndëve është 107 për qind.





# Vazhdojnë aktivitetet për shënimin e 'Epopesë së korrikut 1998' në Rahovec

RAHOVEC, 19 KORRIK (ER) - Kanë vazhduar edhe gjatë ditës së enjte aktivitetet për shënimin e "Epopesë së korrikut 1998", në Komunën e Rahovecit. Në aktivitetet të cilat organizohen nga Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me shoqatat e dala nga UÇK-ja, degët në Rahovec, po merr pjesë edhe kryetari i komunës, Smajl Latifi, me bashkëpunëtorë, deputetë të Kuvendit të Kosovës, familjarë dhe bashkëluftëtarë të dëshmorëve.
Aktivitetet për shënimin e "Epopesë së korrikut 1998" kanë vazhduar me bërjen e homazheve në Varrezat e Dëshmorëve në qytetin e Rahovecit, te Muri i Pikëllimit dhe në nderim të veprës së Sheh Myhedinit te Teqeja e Madhe në qytetin e Rahovecit dhe me zbulimin e përmendores së rindërtuar të dëshmorëve në rrugën "UÇK" (transiti Rahovec - Malishevë).
Po të enjten kryetari Latifi ka marrë pjesë në akademinë përkujtimore që është mbajtur në nderim të dëshmorit Hamdi Berisha në shtëpinë e kulturës "Tahir Sinani" në Malishevë.

# Një delegacion i lartë i FSK-së viziton Ministrinë e Jashtme të Francës

PARIS, 19 KORRIK (ER) - Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Burim Ramadani, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe oficeri i lartë, kolonel Jeton Dreshaj, po qëndrojnë për vizitë zyrtare në Republikën e Francës. Delegacioni i MFSK-së, i shoqëruar edhe nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Paris, Qëndrim Gashi, u prit nga Thomas Bertin, drejtor për Ballkanin Perëndimor në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës.
Në takimet që zhvilloi delegacioni i FSK-së në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në Ministrinë e Mbrojtjes të Francës janë diskutuar arritjet e FSK-së, bashkëpunimi dypalësh dhe avancimi i marrëdhënieve ndërmjet dy ministrive.
Zëvendësministri Ramadani dhe gjeneral Rama në takimet e tyre me zyrtarët francezë biseduan edhe për sigurinë në Kosovë dhe rajon, si dhe për të ardhmen e FSK-së dhe mundësitë që FSK-ja në të ardhmen të bëhet pjesë e operacioneve paqeruajtëse krahas ushtrive të vendeve të NATO-s.
Në të gjitha takimet e delegacionit të MFSK-së me zyrtarët francezë u arrit konstatimi se bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Francës për çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes është kontribut për partneritetin e përgjithshëm midis dy vendeve si dhe për sigurinë rajonale dhe më gjerë.



# 'Festa e Miqësisë' organizohet edhe në Mitrovicë

MITROVICË, 19 KORRIK - Sot (e premte) në Sheshin "Isa Boletini" në Mitrovicë do të mbahet festivali "Festa e Miqësisë". Ky aktivitet, i dedikuar miqësisë së vërtetë, do të mbahet nën organizimin e "Agna Group" dhe kompanisë "Connext", me mbështetjen e Komunës së Mitrovicës.
Festa do të fillojë nga ora 19:00 dhe do të zgjasë deri më 22 korrik.
Në këtë festival do të përformojnë këngëtarë të mirënjohur nga Shqipëria si Aleksandër Gjoka, Redon Makashi dhe Elton Deda që tashmë njihen si tre musketierët si dhe emra të njohur të skenës shqiptare, si: BB Poqi, Valon Shehu, Anxhela Peristeri, Mateus Frroku, Offchestra Band, Renis Gjoka, Kachinari.
Përgjatë këtyre netëve në qytetin e Mitrovicës do të mbretërojë një atmosferë miqësore dhe shumë argëtuese.



## Normalizohet gjendja në Turqi

Ankara, 19 korrik - Qeveria turke i ka dhënë fund gjendjes së jashtëzakonshme që ishte vendosur dy vjet më parë, pas tentimeve të dështuara për grushtshtet, kanë thënë mediet shtetërore. Gjatë kësaj periudhe, dhjetëra mija persona janë arrestuar dhe janë shkarkuar nga pozitat e tyre në punë. Sidoqoftë, Qeveria ka vendosur të mos vazhdojë këtë gjendje më, thuhet në njoftim.
Vendimi vjen disa javë pasi presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka fituar një tjetër mandat si president. Gjatë fushatës presidenciale, kandidatët e tjerë kanë thënë se vendimi i tyre i parë në rast të fitores do të ishte dhënia fund e kësaj gjendje.
Më shumë se 107 000 persona janë shkarkuar nga puna dhe më shumë se 50 000 të tjerë janë burgosur, në pritje të gjykimit, është bërë me dije nga statistikat zyrtare dhe organizatat joqeveritare.
Shumica e personave të shkarkuar dyshohet se janë mbështetës së klerikut fetar Fethullah Gulen, i cili jeton në ShBA. Turqia akuzon Gulenin dhe përkrahësit e tij për organizim të puçit të dështuar, derisa ai vazhdimisht i mohon këto pretendime.



# DASh-i, kundër marrjes së amerikanëve në pyetje nga Rusia

Vladimir Putini, në Samitin e Helsinkit, tha se prokurori i posaçëm amerikan Robert Mueller mund të vijë në Rusi dhe t'i hetojë 12 rusët e paditur nëse Kremlini mund t'i marrë në pyetje 11 amerikanë që dyshohet se kanë bërë veprime të paligjshme në Rusi, por DASh-i ka denoncuar kërkesën e Rusisë për një gjë të tillë



Uashington, 19 korrik - Departamenti i Shtetit ka denoncuar kërkesën e Rusisë për t'i marrë në pyetje disa shtetas amerikanë në këmbim të lejimit të një hetuesi amerikan që të marrë në pyetje 12 zyrtarë rusë të paditur nga prokurori i posaçëm Robert Mueller për ndërhyrjen e tyre në zgjedhjet amerikane.
Një nga amerikanët që Kremlini dëshiron ta marrë në pyetje është ish-ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Rusi. Shtëpia e Bardhë tha se presidenti amerikan nuk ka përjashtuar mundësinë e lejimit të zyrtarëve rusë për t'i marrë në pyetje amerikanët.
Gjatë Samitit të Helsinkit mes presidentit amerikan Donald Trump dhe homologut të tij rus Vladimir Putin, udhëheqësi rus ofroi një marrëveshje. Ai tha se prokurori i posaçëm amerikan Robert Mueller mund të vijë në Rusi dhe t'i hetojë 12 rusët e paditur nëse Kremlini mund t'i marrë në pyetje 11 amerikanë që dyshohet se kanë bërë veprime të paligjshme në Rusi.
Synimi kryesor i Moskës është investitori me qendër në Londër, Bill Browder, i cili i ka prishur marrëdhëniet me Kremlinin. Vladimir Putini pretendon se bashkëpunëtorët e Browderit kanë realizuar fitime të mëdha në Rusi pa paguar taksa dhe se disa nga paratë janë transferuar jashtë vendit me ndihmën e oficerëve amerikanë të zbulimit.
Departamenti i Shtetit hodhi poshtë pohimet e Rusisë, duke i quajtur ato "absolutisht absurde". "Ne vazhdojmë t'u bëjmë thirrje autoriteteve ruse të punojnë me Departamentin Amerikan të Drejtësisë për t'i ndjekur ata në Rusi të cilët, në fakt, kanë kryer skemën mashtruese së cilës i referohet Rusia dhe që kishte në shënjestër jo vetëm Browder, por edhe kompaninë e tij dhe të tjerët, si dhe popullin rus në përgjithësi", tha Heather Nauert, zëdhënëse e Departamentit të Shtetit.
Por Shtëpia e Bardhë nuk e ka hedhur poshtë ofertën e Putinit. "Ka pasur disa biseda për këtë, por ShBA-ja nuk ka ndërmarrë asnjë angazhim. Presidenti do të punojë me ekipin e tij dhe ne do t'ju njoftojmë nëse do të ketë ndonjë zhvillim mbi këtë çështje", tha Sarah Sanders, zëdhënëse e Shtëpisë së Bardhë.
Prokurorët rusë duan të marrin në pyetje disa ligjvënës amerikanë, oficerë të sigurisë dhe diplomatë, duke përfshirë ish-ambasadorin e amerikan në Rusi, Michael McFaul. McFaul i ka kërkuar Shtëpisë së Bardhë të dënojë në mënyrë kategorike atë që ai e quajti "kërkesë qesharake nga Putini". Por, edhe para Samitit të Helsinkit, McFaul shprehu shqetësimin rreth qëndrimit të Trumpit ndaj Rusisë. "Frika ime më e madhe është se presidenti Trump do të jetë shumë miqësor dhe lavdërues me Vlaidmir Putinin", tha ish-ambasadori amerikan në Ukrainë.
Trumpi i hodhi poshtë këto kritika. "Asnjë president nuk ka qenë më i ashpër sesa unë kundër Rusisë. Ju duhet të shikoni se çfarë kemi bërë. Shikoni sanksionet. Shikoni ambasadorët që ne kemi tërhequr", tha Trumpi.
Në një zhvillim tjetër, një grua që dyshohet se është agjente e Rusisë është arrestuar në ShBA. Ministria e Jashtme ruse thotë se arrestimi i së dielës ishte një përpjekje për ta minuar suksesin e samitit Trump-Putin para se ai të ndodhte.
Por presidenti rus Vladimir Putin fajësoi sot forcat politike brenda ShBA-së se po përpiqen të minojnë samitin e tij me presidentin Donald Trump në Helsinki, ndërkohë që udhëheqësi amerikan e quajti takimin "një sukses të madh" dhe tha se mezi priste të takoheshin përsëri.
Në komentet e tij të para publike për takimin me Trumpin, presidenti Putin u tha diplomatëve ruse: "Ne shohim se ka forca në ShBA të cilat janë të gatshme të sakrifikojnë pa shkak të marrëdhënieve ruso-amerikane për hir të ambicieve të tyre në suazën e një beteje të brendshme politike në ShBA".

## Spanja tërheq fletarrestimin kundër ish-presidentit të Katalonjës

Madrid, 19 korrik - Gjykata Supreme e Spanjës e tërhoqi fletarrestimin evropian kundër ish-presidentit të Katalonjës, Carles Puigdemont, dhe pesë ndihmësve të tij që mbeten jashtë vendit. Një gjykatë në Gjermani konstatoi më herët se Puigdemont nuk mund të ekstradohet për t'u përballur me akuzat e Spanjës për rebelim për shkak të shtytjes së tij për pavarësinë e Katalonjës.
Rebelimi është akuza më serioze që është ngritur kundër Puigdemont.
Por, akuzat kundër gjashtë separatistëve katalanas mbeten, çfarë do të thotë se ata ende përballen me arrestim nëse kthehen në Spanjë.
Gjykata rajonale në Shlesvih-Hollstajn në Gjermani tha se Puigdemont mund të ekstradohet për akuzën e keqpërdorimit të fondeve publike, por jo për rebelim apo për kryengritje.
Gjykatësi i lartë spanjoll, Pablo Llarena, tha se duke vepruar kështu, gjykata gjermane tregoi një "mungesë angazhimi" me rastin dhe shkeli rregullat e fletarrestimit.
Ai e akuzoi atë për minimin e kompetencave të Gjykatës Supreme spanjolle.



# Parku Arkeologjik Ulpiana do ta ketë mbështetjen e MKRS-së

PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vizituar të enjten Parkun Arkeologjik Ulpiana, për t'i parë nga afër punimet që po zhvillohen nga Instituti Arkeologjik i Kosovës, punimet e tjera në bashkëpunim me Universitetin L'Ecole Normale Superiore Paris dhe Universitetin e Prishtinës, sipas marrëveshjes së nënshkruar vitin e kaluar. "Sot jam këtu që të shoh nga afër punimet të cilat po zhvillohen nga Instituti Arkeologjik i Kosovës, në procesin e gjurmimeve të rregullta arkeologjike, të konservimit-restaurimit, por edhe të mirëmbajtjes së parkut arkeologjik në përgjithësi. Po ashtu, gjatë kësaj vizite dua t'i shoh nga afër punimet e tjera specifike të cilat zbatohen në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtarë, universitete dhe institucione të tjera shumë të rëndësishme e që në rastin e Ulpianës kanë qenë në numër të konsiderueshëm", ka thënë ministri Gashi. Ai ka shtuar se e vlerëson angazhimin e Institutit Arkeologjik, arkeologëve, profesorëve të Universitetit L'Ecole Normal Superiore Paris (me karakter shkencor, kulturor dhe profesional) dhe atyre të Universitetit të Prishtinës. Po ashtu, ministri përgëzoi studentët e Universitetit Veror që iu kanë bashkangjitur këtij ekipi profesional.

Ministri Gashi ka thënë se Parku Ulpiana do të ketë mbështetje të vazhdueshme. "Parku



Arkeologjik Ulpiana do ta ketë mbështetje të vazhdueshme deri në funksionalizimin e plotë të tij, në kuptimin e punimeve, krijimit të kushteve më të mira për vizitorë dhe promovimit të këtij parku", ka thënë Gashi. Ai ka inkurajuar që këtë mbështetje ta kthejnë në angazhime të shtuara dhe në shkëmbim të përvojave mes kuadrosh profesionale dhe që gjeneratave të reja t'u mundësohet të marrin më shumë njohuri dhe përvojë. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka theksuar se "nga ky park, paraprakisht lokalitet arkeologjik ka shumë të rinj që kanë filluar angazhimin e tyre si praktikantë, kurse sot studiojnë në universitete prestigjioze në Evropë, por edhe udhëheqin projekte të gërmimeve brenda Kosovës. E rikonfirmoj se është shembulli më i mirë që duhet ndjekur". Në fund të fjalës së tij, ministri Gashi ka pohuar se nga ekipi përgjegjës pret që "ta finalizojë Planin e Menaxhimit dhe një botim, në formë të monografisë për Parkun Arkeologjik Ulpiana".

# Ministri Gashi: Kemi rritur përkrahjen për rininë

Prishtinë, 19 korrik (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në një ceremoni për nënshkrimin e kontratave me të rinjtë përfitues të shpalljes së fundit nga ana e MKRS-së, për edukim joformal, ka pritur të enjten në kabinetin e tij përfaqësues të 22 organizatave rinore.

Pas nënshkrimit të këtyre kontratave, ministri Gashi ka thënë se përmes kësaj mbështetjeje, MKRS-ja po vazhdon përpjekjet për nxitjen e edukimit joformal. "Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit progresivisht ka rritur përkrahjen për rininë, në veçanti në vitet e fundit. Qëllimi kryesor i këtyre temave të përkrahura është ideja e përafrimit të të rinjve kosovarë me parimet dhe praktikat më të mira evropiane dhe promovimi i vlerave demokratike dhe qytetarisë aktive tek të rinjtë përmes edukimit dhe krijimi i kulturës së të mësuarit gjatë gjithë jetës duke ua ofruar të rinjve aftësitë dhe njohuritë që ata kanë nevojë për të përparuar në një shoqëri të globalizuar", ka thënë ministri Gashi.

Ai ka theksuar se MKRS-ja do të ketë një rol kyç në përkrahjen e nismave të shoqërisë civile për të përmbushur katër qëllime bazike: Qëllimin ekonomik, sipas të cilit do t'i aftësojë të rinjtë që të jenë ekonomikisht të përgjegjshëm dhe të pavarur; Qëllimin kulturor, sipas të cilit, do t'i aftësojë të rinjtë që ta kuptojnë kulturën e tyre dhe të respektojnë diversitetin; Qëllimin social, sipas të cilit, do t'i aftësojë të rinjtë që të jenë qytetarë aktivë; dhe Qëllimin personal, sipas të cilit, do t'i aftësojë të rinjtë ta njohin botën e tyre të brendshme dhe mjedisin që i rrethon.

Ministri Gashi u zotua se "do të përmbushen të gjitha detyrimet që Qeveria e Kosovës ka mandatuar Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në tematikën e edukimit joformal". Ai ka sqaruar se nënshkrimi i këtyre kontratave bëhet pas thirrjeve që bën Departamenti i Rinisë në kuadër të MKRS-së dhe zgjedhja e përfituesve bëhet pas vlerësimit nga ana e një komisioni përzgjedhës ku përfshihet edhe shoqëria civile. "Më vjen mirë që në kuadër të këtyre organizatave që kanë përfituar në këtë thirrje, ka edhe organizata të cilat implementojnë projekte për persona me aftësi të kufizuara", ka theksuar ministri Kujtim Gashi.

Ndërkaq përfaqësues të këtyre të rinjve u shprehën falënderues për ftesën e ministrit dhe për nënshkrimin e këtyre kontratave. "Për neve është nder i madh që një ministër na fton për nënshkrimin e kontratave. Këtë vit me Ministrinë e Kulturës e kemi shënuar një hap të madh në cilësinë e mbështetjes që e kemi pasur prej Ministrisë. Gatishmëria, përkushtimi, vullneti dhe përzemërsia që ka treguar Ministria e Kulturës për neve do të thotë shumë dhe ne jemi thellësisht mirënjohës", u shpreh një nga ta.



# Kosova hapë thirrjen për propozime për OSCAR

PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK) fton të gjithë të interesuarit të dërgojnë propozime për konsiderim për çmimin OSCAR për kategorinë për film në gjuhë të huaj, i cili mund ta përfaqësojë Kosovën këtë vit. Sipas një njoftimi të QKK-së, të drejtën e konkurrimit e kanë të gjithë filmat e metrazhit të gjatë nga Kosova që janë shfaqur apo do të shfaqen për shtatë ditë rresht në kinematë e Kosovës duke filluar nga data 1 tetor 2017 dhe jo më larg se data 30 shtator 2018 dhe të cilët i plotësojnë kushtet e tjera të vëna nga Academy of Motion Picture Arts and Sciences", është thënë në njoftimin e QKK-së.

Komisioni përzgjedhës i Kosovës këtë vit kryesohet nga regjisori i shquar Isa Qosja, ndërsa anëtarët e tjerë janë aktori dhe producenti Fatmir Spahiu, skenaristja Visare Aliu, aktori e regjisori Edon Rizvanolli, producenti Valon Jakupaj, regjisori Faton Bajraktari dhe aktori e producenti Shkumbin Istrefi.



E rrallë

## Djali dyvjeçar ngecën në tenxhere

Një fëmijë i vogël i familjes Turan në Turqi filloi të luante në kuzhinë kur prindërit ishin në gjumë. Këmbët e tij të vogla ngecën në një tenxhere me presion dhe vogëlushi filloi të qante me të madhe. Prindërit e tij telefonuan emergjencën pasi nuk arrinin ta nxirrnin. Për fatin e mirë, grupi i zjarrfikësve ia doli ta shpëtonte dyvjeçarin duke përdorur pajisjet prerëse.



FOTO E DITES




Ish-presidenti amerikan Barak Obama duke mbajtur fjalim në leksionin e 16 vjetor Nelson Mandela në Johanesburg të Afrikës së Jugut. /AP/

E jashtëzakonshme

## Guri gjigant shkëputet nga shkëmbi, shpëtojnë mrekullisht katër persona

Një incident i rëndë ka ndodhur në Sichuan në jug perëndim të Kinës, ku një makinë është goditur nga një gur gjigant, i cili u shkëput nga një shkëmb si pasojë e reshjeve të shiut. Guri ka rënë sipër makinës por, fatmirësisht, katër personat kanë shpëtuar.



## BARSOLETA E DITËS



**E dashura: Shpirt, më duket vetja shumë e shëndoshë, e shëmtuar dhe e plakur. Të lutem, më bëj një kompliment.**
**I dashuri: Zemër, ke shikim shumë të mirë.**

KINO ABC PRISHTINE

### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Vetem gjate vikendit në ora 16:00**

### " INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird







**Në ora 18:20**

### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco

**Në ora 20:00**

### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed







**Në ora 22:00**

### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot duhet të bëni të pamundurën të mbyllni me sukses çdo iniciativë ose aktivitet që filloni.



**DEMI**
Gjatë ditës së sotme do të takoni shumë persona të rinj dhe do të ndikoheni mjaft pozitivisht prej tyre. Këto njohje do t'ju ndihmojnë në të ardhmen.



**BINJAKËT**
Meqenëse keni marrë shumë gjëra përsipër, sot jeni mjaft në tension që t'u dilni zot të gjithave. Nëse nuk do të arrini në ndihmë do t'ju vijnë familjarët.



**GAFORRJA**
Gjërat tuaja të vogla dhe personale mbase nuk janë në interesin e të gjithëve dhe nuk keni pse i bëni shumë publike. Merruni me çështje më madhore.



**LUANI**
Do të hasni në mjaft problematika sot gjatë ditës, por nëse nuk filloni t'i zgjidhni, do të mblidhen të gjitha në fund.



**VIRGJËRESHA**
Nëse jeni të interesuar për t'i shprehur dashurinë personit që keni në krah ose dikujt që sapo e keni njohur, sot është dita ideale për ta bërë.



**PESHORJA**
Duhet të punoni shumë që rezultatet të jenë ato që prisni në një projekt të caktuar. Duke qëndruar në pritje nuk do të arrini asgjë.



**AKREPI**
Nëse doni të ndiheni të lumtur këtë periudhë duhet të jeni më të pranishëm me familjarët tuaj për t'i rivendosur dialogët e ndërprera prej kohësh.



**SHIGJETARI**
Keni marrë vendime që kanë ndikuar shumë në karrierën tuaj dhe do të ndikojnë dhe në financat tuaja në të ardhmen.



**BRICJAPI**
Edhe pse po mundoheni shumë që të dukeni bukur karshi një personi të caktuar nuk do të bëjë ndonjë diferencë të madhe në jetën tuaj personale.



**UJORI**
Duhet t'u kushtoni më shumë vëmendje veprimeve tuaja sepse sot dikush po ju vëzhgon nga lart dhe nuk do t'i pëlqejë një sjellje e juaja.



**PESHQIT**
Duhet të jeni krenar për veten sepse po tentoni në të gjitha mënyrat të shpëtoni një raport që ka mjaft probleme që në fillim të tij.

# Ronaldo ia lë bakshish 20 mijë euro hotelit ku kaloi pushimet



Cristiano Ronaldo vazhdon të jetë lojtari më i përfolur këto ditë në botën e futbollit. Portugezi javën e kaluar kaloi nga Real Madridi te Juventusi për 100 milionë euro dhe një rrogë vjetore prej 30 milionë eurosh. Para se ky transferim të kompletohej, CR7 ishte duke pushuar me familje në Greqi. Pushimet e tij janë bërë edhe një herë lajm, këtë herë për bakshishin që Ronaldo ia ka lënë hotelin grek ku po pushonte. I kënaqur nga shërbimi, portugezi la bakshish 20 mijë euro.

# Miley Cyrus ndahet nga Liam Hemsworthi



Miley Cyrus dhe Liam Hemsworth bëhet me dije se kanë hequr dorë nga martesa e tyre pas fjalosjes rreth periudhës se kur do të krijojnë familje. Çifti që u fejua në vitin 2012 duket se i ka dhënë fund lidhjes me dëshirën e tyre. "Ai dëshiron fëmijë dhe nuk dëshiron të vonohet në këtë aspekt të jetës, por nuk është aspak koha që Miley të ketë fëmijë. Ai ka mbetur i zemëruar", thotë një burim për edicionin australian të revistës "OK!"



# Xhaka dhe Leonita bëjnë simbolin e shqiponjës në pushime

Futbollisti i njohur shqiptar, Granit Xhaka dhe bashkëshortja e tij, Leonita, janë duke shijuar së fundmi disa ditë të mira pushimi. Për pushimet verore ata kanë zgjedhur ishullin luksoz Seychelles në Afrikën Lindore. Në disa imazhe të publikuara në rrjetin social "Instagram" çifti kanë treguar se po ia kalojnë si është më së miri në shoqëri të njëri-tjetrit. Graniti dhe Leonita në një fotografi, shfaqen të ulur buzë detit, teksa me bashkimin e duarve të tyre bëjnë simbolin e shqiponjës.

# Kylie Jenneri zbulon si lindi romanca me Travis Scotti

Romanca e Kylie Jennerit dhe Travis Scottit i habiti të gjithë pasi jeta e tyre ndryshoi rrënjësisht kur u bënë prindër të një vajze. Për herë të parë kanë dhënë një intervistë për "GQ", ku kanë treguar detajet e lidhjes së dashurisë. "Ne nuk dalim në takime. Madje takimi ynë i parë nuk ka qenë një takim nga ata të zakonshmit mes dy personave që pëlqehen. Ne jemi takuar në Coachella, madje nuk e mbaj mend ku. Gjithçka ndodhi atë natë, ishte një bisedë dhe një shëtitje që shkoi mirë. Unë i tregova Travisit një histori dhe arrita ta fitoja vëmendjen e tij", ka treguar Kylie.





| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | VËLLIMI, MASA | VËMENDJE E KUJDES I VEÇANTË QË TREGOJMË PËR DIÇKA (shq.) | AI QË DEHET ME ETER | SHKRIMTARJA KAMBERI | MIRË DE, NË RREGULL | SHTET NË AFRIKË | ZANORE | LLOJ PJEPRI I VERDHË, I QULLËT E ME SHUMË LËNG, POR JO I SHIJSHËM | PËRHAPJA E VALËVE | BASHKËT. | EPOKA E RE |
| | | | | | | AKTORJA ANGLEZE NË FOTO | | | | | | | | | | | JAM I DENJË TË NDEROHEM E VLEJ TË MË JEPET NJË ÇMIM |
| | | | | | | MJET PËR PËRÇIMIN E VALËVE (shq.) | | | | | | | ALYSSA MILANO | | | BASHKËT. / ORGANI I RIPRODHIMIT TË BIMËVE | |
| | | | | | | SHTERPË / QYTET NË SHQIPËRI | | | | | | | KAFSHË SHTËPIAKE PËRTYPËSE / TENISTI SAFIN | | | | |
| | | | | | | | | | | | AXHAMI, KALAMA / AGIM TEJECI | | | | | | |
| | | | | | | ERA E KËNDSHME | | | | | | KOMPOZITORI KOCI (shq.) / PËRFYTYRIM IDEAL I SHOQËRISË NJERËZORE | | | | | |
| | | | | | | LETRARI ..... ZYKO KAMBERI | QË I PESHON MIRË VEPRIMET A FJALËT; E KUJDESSHME / DILETANTET | | | | | | | AKTORI HOLLIVUDIAN ... DAMON (shqip.) / KËPUCË PËR RRËSHQITJE MBI AKULL | | | |
| | | | | | | | | | | | DOKUMENT I VJETËR MBI PRONËSINË E TOKËS / HISTORIANJA ...... KEÇMEZI BASHA | | | | | OHIO / ISH PRESIDENTI AMERIKAN HARRY | |
| EPOKA E RE | QË BËHET NDËRMJET TRI PALËVE | BARAZIM NË SHAH | PUNËTOR QË PASTRONTE E RREGULLONTE DHOMAT NË HANE (vjet.) | 3.14 (mat.) | ZANORE | SHTET FEDERAL NË SHBA / LETRARI XOXA | | | | | | | | | DY BASHKË-TINGËLLORE / KAMPIONI | | |
| QYTET NË SHQIPËRI | | | | | | | | ISLANDA / KËNGËTARJA KANADEZE MORISSETTE | | ANTON PASHKU / KUNDREJT E VJETËR | | | RAST / FILMI I PARË SHQIP | | | | MUZIKOLOGU SHQIPTAR SOKOLI |
| ISH FUTBOLLISTI SHQIPTAR .... JUPI | | | | | PËREMËR VETOR / DY BASHKË-TINGËLLORE | | | | E MBARUAR, E PËRFUNDUAR / ZANORE | | | | | | | | |
| KËNGËTARJA ANGLEZE BUNTON | | | | TRAJNERI BRAZILIAN LUIZ FELIPE / SHKRITËTIRA MË E THATË NË BOTË | | | | | | | | SHPIRTI (Lat.) / SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE | | | | | |
| FILOZOF NË GREQINË E LASHTË | | | | | | | | | PRINCESHA RUMUNE ..... GJIKA / EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN | | | | | | ARIAN MALIQI / SHTET NË AZI | | |
| QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE | | | | | DAMARI I GJAKUT / REKUIZITË SPORTIVE (shq.) | | | | | FRYMA / KOHË BRENDA SË CILËS DUHET TË KRYHET NJË PUNË | | | | KRYEPROKURORJA E SHQIPËRISË ... RAMA / DY BASHKË-TINGËLLORE | | | |
| VEGËL MUZIKORE E PËRDORUR QË NË KOHË TË LASHTA (sh.shq.) | | | | | | KËNGËTARJA .... TARNER / SHINË E TRENIT | | | | | ZANORE / ERNEST KOLIQI | | ROBERT REDFORD | | | BASHKËT. / SHENJA MUZIKORE | |
| SHKRONJA VIII & XVIII | | | HATA / FARISHTË | | | | DËSHMORI ..... PECI / VIJË A RREMB UJI QË KALON NËN TOKË | | | | | | SHTET NË AFRIKË / TEPSI PREJ BALTE (sh.shq.) | | | | |
| BASHKËT. | | I VRULLSHËM / SHAPKA | | | | | | MODEL I ZVOGËLUAR I NJË OBJEKTI RRAFSHNALTË E MADHE NË AZI (pashq.) | | | | | | TRUP GJEOMETRIK / MJET SI KAMBANË FA-RE E VOGËL (sh.shq.) | | | |
| EPOKA E RE | FURRË KU PIQEN TULLA (sh.shq.) / ATDHE | | | | | | | | BASHKËT. / KAJDE, OJNA (sh.shq.) | | LËNG QË NXIRRET NGA KULLIMI I NAFTËS / DHELPËRI (sh.shq.) | | | | | | ISH FUTBOLLISTI YNË SHAQIRI |
| PATRIOTI PASHKO | | | | | "ASHTU QOFTË" / TOKË E BUKËS (sh.shq.) | | | | | FUTBOLLISTI SPANJOL MARTINEZ (shqip.) | | | | | SHKRONJA TË NJËJTA / POETI .... RAÇI | | |
| VËLLAI I MADH | | | | LLOJ KARROCE KUAJSH / NJËSI KOHE | | | | | | ZANORE / GAZETARJA SHIPTARE ... TIÇO | | EMRI I PASHAIT TË JANINËS | | | | SHKRONJA XXIV / SHOUMENI KRASTA | |
| MUAJ I VITIT | | | | | | NJERI I PACIPË E I PAFYTYRË, NJERI I POSHTËR / MARK ANTONI | | | | | | OBJEKTI I BISEDËS (sh.shq.) / NJË NGJYRË | | | | | |
| ATALANTA, LIVORNO | | | KORNIZË / BASHKËT. | | | | FUTBOLLISTI ARGJENTINAS KARLOS ..... / BASHKËT. | | | | | | ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHERINGAM / BASHKËT. | | | | |
| ANIJATË; PJESË E BRENDSHME E NJË KISHE (sh.shq.) | | | | | | | | FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE | | | | | | VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE | | | |

# Dy vjet pas puçit në Turqi, ja bilanci i gjendjes së jashtëzakonshme

Dy vjet zgjati gjendja e jashtëzakonshme në Turqi. Pas përpjekjes për puç në korrik 2016, presidenti Erdogan ka goditur ashpër. Tani hiqet gjendja e jashtëzakonshme. A do bëhet gjithçka më mirë? Bilanci është ky.

### Pse është vendosur gjendja e jashtëzakonshme në Turqi?

Mbas përpjekjeve për puç më 15 korrik 2016 qeveria turke deklaroi se përgjegjës janë anëtarë të Lëvizjes Gülen, që ndodhen në radhët e ushtrisë. Presidenti turk Recep Tayyip Erdogan e quajti organizatë terroriste Lëvizjen




© DW/K. Köylü

Gülen dhe vendosi gjendjen e jashtëzakonshme për tre muaj, në mënyrë që të luftonte në mënyrë aktive kundër saj. Për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme qeveria mori të drejtën të reagonte pa dekrete. Kështu në institucionet shtetërore u vendosën rregulla të reja.

Për shkak të shkarkimeve masive nga puna në shërbimet publike dhe arrestimet e shumta, opozita e quajti gjendjen e jashtëzakonshme si „puç civil dhe persekutim kundër kritikëve të qeverisë” dhe kërkoi heqjen e menjëhershme të gjendjes së jashtëzakonshme, por pa sukses. Gjendja e jashtëzakonshme u shty shtatë herë gjithsej.

### Sa vetë janë arrestuar?

Gjatë gjendjes së jashtëzakonshe u lëshuan gjithsej 32 dekrete. Sipas të dhënave zyrtare në pyetje u morrën 160 mijë vetë dhe më shumë se 70 mijë vetë u arrestuan, mes tyre edhe gazetarë, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe politikanë të opozitës. Kundër 155 mijë vetëve u zhvilluan hetime për „anëtarësim në një organizatë terroriste”.

Me dekretet e gjendjes së jashtëzakonshme koha e mbajtjes në arrest u zgjat në 30 ditë. Kjo praktikë u përdor deri në fund të 2016. Vetëm pas një paralajmërimi nga Këshilli i Evropës, në fillim të vitit 2017, koha e mbajtjes në arrest u zvogëlua në 14 ditë.

### Sa vetë u shkarkuan nga puna?

Gjatë dy vjetëve që zgjati gjendja e jashtëzakonshme u shkarkuan nga puna në shërbimin publik 121 131 vetë. Rreth 7 mijë vetë u shkarkuan nga universitetet, 5700 prej tyre nga forcat akademike. Po ashtu u mbyllën shkolla dhe qendra arsimore, për të cilat dyshohej se kishin lidhje me lëvizjen Gülen.

Të drejtat e zgjeruara nuk u përdorën vetëm kundër idhtarëve të Lëvizjes Gülen, por u përdorën edhe kundër forcave opozitare. Kështu për shembull në territoret kurde rreth 100 kryetarë bashkish u zëvendësuan nga administratorë të detyrueshëm dhe shumë politikanë kurdë u arrestuan. Organizata ndërkombëtare si OKB ose Këshilli i Evropës kanë kritikuar qeverinë turke për këtë dhe kanë folur për një „zhvillim alarmant”.



### Si ka qenë puna me lirinë e shtypit?

Me dekretet e gjendjes së jashtëzakonshme u mbyllën 70 gazeta dhe 20 revista si dhe 34 stacione radioje, po ashtu si 30 shtëpi botimi dhe 33 stacione televizive. Hetimet kundër përfaqësuesve të mediave dhe arrestimet e gazetarëve për „propagandë në ndihmë të terrorizmit” ose “ofendimin e presidentit të shtetit” janë parë nga organizatat si në Turqi ashtu edhe jashtë saj.

Sipas të dhënave të sindikatës së gazetarëve në Turqi ndodhen 143 gazetarë në burg. Organizata “Reporterët pa kufi” ka tërhequr vëmendjen se me masat represive gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme, shtypi u bë gjithnjë e më shumë njësoj. Në vitin 2010 Turqia ndodhej në vendin 138 në vlerësimin ndërkombëtar të vendeve për lirinë e shtypit. Ndërkohë Turqia ka përfunduar në vendin e 157.

### Çfarë ndodh pas heqjes së gjendjes së jashëzakonshme?

Gjendja e jashtëzakonshme hiqet, por presidenti Erdogan do vazhdojë të qeverisë me dekrete. Sepse në sistemin e ri presidencial ai ka të drejtën që të rregullojë me dekrete presidenciale disa fusha. Siç është bërë deri tani me dekretet e gjendjes së jashtëzakonshme, edhe dekretet presidenciale kanë të drejtën si një ligj dhe madje me efekt të menjëhershëm.

Përveç kësaj qeveria ka ashpërsuar ligjin kundër terrorizmit. Projektligji për ligjin e ri parashikon që guvernatorët të kenë të drejtë të kufizojnë hyrjen dhe daljen në qytete për 15 ditë dhe po ashtu të drejtën që të ndalojnë grumbullimet. Për grumbullimet dhe protestat ligji parashikon që “ato nuk duhet të vështirësojnë jetën e përditshme.” Edhe për të dyshuarit për terrorizëm ekzistojnë rregulla të reja. Pasaportat e personave kundër të cilëve zhvillohen hetime për terrorizëm mund të konfiskohen për tre vjet. Ligjet e reja kritikohen sepse faktikisht ato vendosin një lloj gjendje të jashtëzakonshme.

*(gazeta-Shqip.com)*



© picture-alliance/abaca/E. Uludaglar




# Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | NEMAN GRODNO -V SLUTSK | 1 | DUKLA PRAHA - PLZEN | 2 | AAB - MIDTJYLLAND | GG3+ |
|---|---|---|---|---|---|---|

# 2 Korriku, në duar të sigurta

KF 2 Korriku është në duar të sigurta, pasi në krye të shtabit teknik është emëruar Besim Ademi, i cili ka një karrierë të pasur si futbollist dhe golat e tij ishin shumë të rëndësishëm për këtë klub në elitën e futbollit të Kosovës. Suksoset e Ademit janë të mëdha edhe në grupmoshat e 2 Korrikut, pa harruar edhe arsimimin jashtë vendit. "Ka qenë kërkesë edhe këtë vit e kryesisë që ta marr ekipin e parë dhe kjo është një punë me përgjegjësi më të madhe. Do të punoj maksimalisht që 2 Korriku të zhvillojë lojëra të bukura dhe të marrë rezultate pozitive", ka thënë Besim Ademi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI



**Prishtinë, 19 korrik** - Besim Ademi është trajner i ri i skuadrës së 2 Korrikut nga Prishtina. Ai ka qenë një nga lojtarët më të mirë në këtë klub, kurse më pas u dëshmua edhe si trajner i suksesshëm me grupmoshat e reja, çfarë ndikoi që kryesia e klubit një vit më parë t'i ofrojë detyrën e trajnerit në skuadrën e seniorëve, por Ademi e kishte refuzuar këtë ofertë dhe e vazhdoi punën me grupmoshat U17.

